- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë

anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rastë]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmblidhjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për eficientësinë e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Kohëzgjatja e përgjithshme e kontrates: 8 muaj nga data e nënshkrimit të kontrates.

Shërbimi që kërkohet:

Mbështetje me ekspertizë ligjore, financiare, teknike dhe mjedisore për projektin e investimit “Pashaliman Laguna Eko Resort”

Afatet e ekzekutimit:

Nr	Detyrat	Afati maksimal
1	Hartimi i raportit të vlerësimit nga Ekspert Vlerësues i licencuar për pronën që do t'i vihet në dispozicion këtij projekti investimi. Vlerësimi do të bëhet në një ose më shumë metoda vlerësimi sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. <i>Raporti perfundimtar i vlerësimit duhet të dorëzohet në gjuhën shqip dhe anglisht në 2 (dy) kopje për secilën nga gjuhët e kërkuara dhe një kopje në versionin elektronik (MS word Format) shqip/anglisht.</i>	10 ditë nga kërkesa e Autoritetit Kontraktor
2	Analiza ligjore, financiare, teknike dhe mjedisore e dokumenteve të mëposhtme, të paraqitura nga investitori: Analiza duhet të ketë në konsideratë forcimin e pozitave të shtetit shqiptar në këtë investim strategjik dhe duhet të përfshijë të gjitha hipotezat, supozimet, zgjidhjet, treguesit, analizat dhe rezultatet e përcaktuara në dokumentet e dorëzuara nga investitori. a. Planin e plotë të biznesit, në të cilin përcaktohen edhe detyrimet përkatëse të propozuara në ngarkim të investitorit strategjik e të shtetit/entitetit të autorizuar të sigurojë pjesëmarrjen e shtetit, si dhe kostot përkatëse; b. Studimin e plotë të fizibilitetit, i cili përfshin, në mënyrë të detajuar, analizën dhe vlerësimin teknik, ekonomik dhe tregtar të projektit, si dhe provon se projekti është i përshtatshëm dhe i realizueshëm; c. Një relacion shpjegues, ku jepen arsyet e kërkesës për përfshirje shtetërore, mënyra e pjesëmarrjes apo mbështetjes direkte të shtetit në investim dhe një shpjegim i detajuar i vlerësimit të pjesëmarrjes shtetërore, si e nevojshme nga ana e investitorit për suksesin e projektit;	Brenda 10 ditëve sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor

	d. Përshkrimin e detajuar të formës e të nivelit të pjesëmarrjes shtetërore të kërkuar, të shoqëruar me informacione konkrete për aspektet e pjesëmarrjes shtetërore; e. Projektin e plotë zhvillimor të infrastrukturës së brendshme dhe mënyrën e lidhjes së saj me infrastrukturën e jashtme, në rastin kur kërkohet mbështetje me infrastrukturë mbështetëse; f. Të drejta të posacme, që i ofrohen shtetit/entitetit të autorizuar të sigurojë pjesëmarrjen e shtetit nga ana e investitorit, në kuadër të pjesëmarrjes shtetërore në investim, te tilla si, por pa u kufizuar në: i) Vendimarrje me të drejtë vetoje apo me shumicë të kualifikuar në shoqërinë apo partneritetin që propozohet të krijohet; ii) Të drejta të posacme, përtej atyre të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për të emëruar anëtarë të organeve drejtuese, auditorë apo për të marrë informacion për mbarëvajtjen e investimit; iii) Të drejta të posacme në ndarjen e dividendit, të të ardhurave të realizuara apo të cdo përfitimi të drejtëpërdjejtë apo jo të drejtëpërdrejtë në favor të shtetit; iv) Opsionin e daljes së shtetit nga investimi me kushte të paracaktuara apo lehtësisht të vlerësueshme, pas një periudhe kohe nga data e pjesëmarrjes së shtetit në investimin strategjik të propozuar; v) Kufizimet e zbatueshme në lidhje me transferimin e pjesëmarrjeve apo pjesëmarrjen e palëve të treta në investim; vi) Propozimin për zgjidhjen e situatave të bllokimit të vendimarrjes dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Ofertuesi duhet të dorëzojë Raportin i cili duhet të hartohet në gjuhën shqip dhe anglisht në 2 (dy) kopje dhe një kopje në versionin elektronik (MS Word Format) për secilën nga gjuhët e kërkuara.	
3.	Mbeshtetje me ekspertizë ligjore/financiare/teknike dhe mjedisore të Grupit të Negocimit të Marrëveshjes (GNM) dhe AIC lidhur me: a) asistencë në hartimin e planit të veprimit të negociatës, i cili do të shërbejë si dokument orientues bazuar kryesisht në legjislacionin ekzistues, vecanërisht atë për trashëgiminë kulturore. b) asistencë në hartimin e Memorandum Mirëkuptimi mbi bashkëpunimin e Palëve c) përgatitjen e termave dhe çështjeve kryesore mbi të cilat duhen përqendruar negociatat, përfshirë një vlerësim në lidhje me rrishtet e mundshme që lidhen me Projektin dhe që duhen konsideruar për tu adresuar në fazën e negociatave; d) asistencën gjatë fazës së negociatave ndërmjet Grupit të Negocimit të Marrëveshjes dhe investitorit strategjik deri në nënshkrimin e Projekt-Marrëveshjes përfundimtare dhe/ose çdo dokumenti tjetër të lidhur me të; e) përgatitjen e Aktit të Themelimit dhe Statutit të shoqërisë, ku entiteti publik i autorizuar të sigurojë pjesëmarrjen e shtetit do të marrë pjesë si ortak/aksionar, në të	Do të ofrohet në vazhdimësi gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës brenda afatit të përcaktuar rast pas rasti në kërkesën e Autoritetit Kontraktor

	cilën duhet të përfshihen të gjitha kushtet, të drejtat dhe detyrimet e secilës palë; Mbeshtetja me ekspertize ligjore/finaciare/teknike do të konsistojë në: 1. Hartimin dhe dorëzimin e raporteve për çështje të caktuara sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor me shkrim në gjuhën shqip dhe anglisht në 2 (dy) kopje dhe një kopje në versionin elektronik (MS Word Format) për secilën nga gjuhët e kërkuara. 2. Prezencën fizike ose online në takimet që do të zhvillohen gjatë negociatave me investitorin, me 1 ose me shumë ekspertë të stafit sipas rastit dhe në çdo rast kur kërkohej nga Autoriteti Kontraktor.	
--	--	--

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

BAZA LIGJORE

- Ligji Nr. 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”;
- Statuti i Shoqërisë “Korporata e Investimeve Shqiptare” SHA;
- Ligji Nr. 162/2020 “Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
- Vendimi Nr. 285, datë 19. 5.2021, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar
- Vendimi nr. 4, datë 15.07.2025, të Komitetit të Investimeve Strategjike, “Për miratimin e statusit “Investim/investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit “Pashaliman Laguna Eko Resort”.

HYRJE

Me Vendimin nr. 4, datë 15.07.2025, Komiteti i Investimeve Strategjike, ka vendosur miratimin e Statusit “Investim/investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit “Pashaliman Laguna Eko Resort”.

Forma e pjesëmarrjes së shtetit të këtë investim do të realizohet nëpërmjet krijimit të një entiteti juridik të përbashkët të përbërë nga Korporata Shqiptare e Investimeve (AIC) në cilësinë e palës shtet dhe subjektit investitor.

NEVOJA PËR MARRJEN E SHERBIMIT

Me qëllim forcimin e pozitave të shtetit shqiptar është e nevojshme sigurimi i ekspertizë ligjore, financiare, teknike dhe mjedisore për projektin e investimit për Grupin e Negocimit të Marreveshjes dhe Korporatën e Investimeve Shqiptare, në kuadër të zbatimit të projektit të investimit strategjik "Pashaliman Laguna Eko Resort", me synim forcimin e pozitës të shtetit shqiptar në këtë investim strategjik.

PËRSHKRIMI I SHËRBIMIT

Ekspertiza ligjore, financiare, teknike dhe mjedisore për projektin e investimit për Grupin e Negocimit të Marreveshjes dhe Korporatën e Investimeve Shqiptare do të fokusohet në:

1. Hartimi i raportit të vlerësimit nga Ekspert Vlerësues i licencuar për pronën që do t'i vihet në dispozicion këtij projekti investimi. Vlerësimi do të bëhet në një ose më shumë metoda vlerësimi sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

2. Analiza ligjore, financiare, teknike dhe mjedisore e dokumenteve të mëposhtme, te paraqitur nga investitori:

Analiza duhet te kete ne konsiderate forcimin e pozitive të shtetit shqiptar në këtë investim strategjik dhe duhet te perfshijë të gjitha hipotezat, supozimet, zgjidhjet, treguesit, analizat dhe rezultatet e përcaktuara ne dokumentet e dorëzuara nga investitori.

- a. Planin e plotë të biznesit, në të cilin përcaktohen edhe detyrimet përkatëse të propozuara në ngarkim të investitorit strategjik e të shtetit/entitetit të autorizuar të sigurojë pjesëmarrjen e shtetit, si dhe kostot përkatëse;
 - b. Studimin e plotë të fizibilitetit, i cili përfshin, në mënyrë të detajuar, analizën dhe vlerësimin teknik, ekonomik dhe tregtar të projektit, si dhe provon se projekti është i përshtatshëm dhe i realizueshëm;
 - c. Një relacion shpjegues, ku jepen arsyet e kërkesës për përfshirje shtetërore, mënyra e pjesëmarrjes apo mbështetjes direkte të shtetit në investim dhe një shpjegim i detajuar i vlerësimit të pjesëmarrjes shtetërore, si e nevojshme nga ana e investitorit për suksesin e projektit;
 - d. Përshkrimin e detajuar të formës e të nivelit të pjesëmarrjes shtetërore të kërkuar, të shoqëruar me informacione konkrete për aspektet e pjesëmarrjes shtetërore;
 - e. Projektin e plotë zhvillimor të infrastrukturës së brendshme dhe mënyrën e lidhjes së saj me infrastrukturën e jashtme, në rastin kur kërkohet mbështetje me infrastrukturë mbështetëse;
 - f. Të drejta të posacme, që i ofrohen shtetit/entitetit të autorizuar të sigurojë pjesëmarrjen e shtetit nga ana e investitorit, në kuadër të pjesëmarrjes shtetërore në investim, te tilla si, por pa u kufizuar në:
 - Vendimarrje me të drejtë vetoje apo me shumicë të kualifikuar në shoqërinë apo partneritetin që propozohet të krijohet;
 - Të drejta të posacme, përtej atyre të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për të emëruar anëtarë të organeve drejtuese, auditorë apo për të marrë informacion për mbarëvajtjen e investimit;
 - Të drejta të posacme në ndarjen e dividendit, të të ardhurave të realizuara apo të cdo përfitimi të drejtëpërdjejtë apo jo të drejtëpërdjejtë në favor të shtetit;
 - Opsionin e daljes se shtetit nga investimi me kushte të paracaktuara apo lehtësisht të vlerësueshme, pas nje periudhe kohe nga data e pjesëmarrjes së shtetit në investimin strategjik të propozuar;
 - Kufizimet e zbatueshme në lidhje me transferimin e pjesëmarrjeve apo pjesëmarrjen e palëve të treta në investim;
 - Propozimin për zgjidhjen e situatave të bllokimit të vendimarrjes dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
3. Mbeshtetje me ekspertize ligjore/finaciare/teknike dhe mjedisore te Grupit të Negocimit të Marrëveshjes (GNM) dhe AIC lidhur me:

Mbeshtetje me ekspertize ligjore/finaciare/teknike dhe mjedisore te Grupit të Negocimit të Marrëveshjes (GNM) dhe AIC lidhur me:

- a) asistencë në hartimin e planit të veprimit të negociatës, i cili do të shërbejë si dokument orientues bazuar kryesisht në legjislacionin ekzistues, vecanërisht atë për trashëgiminë kulturore.
- b) asistencë në hartimin e Memorandum Mirëkuptimi mbi bashkëpunimin e Palëve
- c) përgatitjen e termave dhe çështjeve kryesore mbi të cilat duhen përqendruar negociatat, përfshirë një vlerësim në lidhje me rrisqet e mundshme që lidhen me Projektin dhe që duhen konsideruar për tu adresuar në fazën e negociatave;
- d) asistencën gjatë fazës së negociatave ndërmjet Grupit të Negocimit të Marrëveshjes dhe investitorit strategjik deri në nënshkrimin e Projekt-Marreveshjes perfundimtare dhe/ose çdo dokumenti tjetër të lidhur me të;
- e) përgatitjen e Aktit të Themelimit dhe Statutit të shoqërisë, ku entiteti publik i autorizuar të sigurojë pjesëmarrjen e shtetit do të marrë pjesë si ortak/aksionar, në të cilën duhet të përfshihen të gjitha kushtet, të drejtat dhe detyrimet e secilës palë;

Mbeshtetja me ekspertize ligjore/finaciare/teknike do të konsistojë në:

Hartimin dhe dorëzimin e raporteve për çështje të caktuara sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor me shkrim në gjuhën shqip dhe anglisht në 2 (dy) kopje origjinale për secilën nga gjuhët e kërkuara dhe një kopje në versionin elektronik (MS Word Format).

Prezencën fizike ose online në takimet që do të zhvillohen gjatë negociatave me investitorin, me 1 ose me shumë ekspertë të stafit sipas rastit dhe në çdo rast kur kërkohej nga Autoriteti Kontraktor.

AUTORITETI KONTRAKTUES

Autoriteti kontraktues për këtë kontratë është Korporata e Investimeve Shqiptare sh.a.

Pika e kontaktit për Autoritetin Kontraktues do të jetë Korporata e Investimeve Shqiptare sh.a

RAPORTIMET

Raportet do të hartohen në gjuhën shqipe dhe anglisht dhe duhet të dorëzohen për secilën nga gjuhët e kërkuara në 2 (dy) kopje të shtypura dhe një kopje në versionin elektronik (MS Word Format).

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës 10.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, 2024**, dhe kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të deshmojë kryerjen e shërbimeve të mëparshme të ngjashme nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës me vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit objekti prokurimi, të realizuar gjatë tre viteve të fundit.

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur vërtetim për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate dhe/ose faturat tatimore perkatese, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit”.*

2.3.2 CV e operatorit ekonomik - një përshkrim i përgjithshëm i profilit të veprimtarisë, të dhëna të përgjithshme lidhur me eksperiencat dhe bashkëpunime në përmbushje të projekteve të ndryshme me natyrë shërbimi në fushën objekti prokurimi (Profili i kompanisë kërkohej, i prezantuar edhe nga prospekti i tij zyrtar (faqe interneti, katalog, etj.).

2.3.3 Përvoja profesionale e ofertuesit. Ofertuesi duhet të paraqesë numrin e projekteve të investimit të suksesshme për të cilat ku ofertuesi ka ofruar shërbime ekspertize të ngjashme me objektin e procedurës së prokurimit për projekte investimi minimumi 5,000,000 Euro (vlera minimale e kërkuar për investitorët apo projektet që përfitojnë statusin referuar ligjit nr. 55/2015 Për investimet strategjike në republikën e Shqipërisë).

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon staf të aftë për kryerjen e shërbimeve objekt të kësaj kontrate, për minimumi 7 (shtatë) eksperte, që të plotësojnë kriteret profesionale, akademike dhe të eksperiencës në fushën përkatëse si vijon:

1. Lideri i ekipit/Ekspert Ligjor

- a. Te jete i diplomuar në shkencat juridike
- b. Te kete kryer studime pasuniversitare ne shkencat juridike
- c. Të kete minimumi 20 (njëzet) vjet përvojë pune ne ofrimin e ekspertizës në fushen kontraktuale, rregullatore, koncesionare, infrastrukturore
- d. Të zotërojë në nivel të lartë profesional të gjuhës angleze

2. 1 (një) Ekspert ligjor

- a. Te jene diplomuar në shkencat juridike
- b. Te kete kryer studime pasuniversitare ne shkencat juridike
- c. Të kete minimumi 20 (njëzet) vjet përvojë pune ne ofrimin e ekspertizës në fushen kontraktuale, rregullatore, koncesionare, infrastrukturore
- d. Të zotërojë në nivel të lartë profesional të gjuhës angleze

3. 1 (një) Analist financiar/biznesi

- a. Te jete diplomuar në shkencat ekonomike/financiare apo ekuivalente
- b. Te kete kryer studime pasuniversitare në shkencat ekonomike/financiare apo ekuivalente
- c. Të kete minimumi 20 (njëzet) vjet përvojë pune në ofrimin e ekspertizës së ngjashme me ekspertizën e kërkuar në këtë procedurë prokurimi
- d. Të zotërojë në nivel të lartë profesional të gjuhës angleze

4. 1 (një) Ekspert ne fushen e mjedisit

- a. Te jete i diplomuar në fushen e inxhinierise se mjedisit ose ekuivalente
- b. Të zotërojë Certifikaten “Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin Mjedisor”
- c. Të kete minimumi 20 vjet përvojë pune ne fushen e mjedisit. Përbën avantazh eksperiencia ne projekte te ngjashme me shërbimet që këkohen.

5. 1 (një) Ekspert ne vlerësimin e pasurive te paluajtshme

- a. Te zotërojë license individuale ne vlerësimin e pasurive të paluajtshme (shkalla e parë) sipas VKM nr 712 datë 12.10.2016 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme" te cilat duhet të jetë në fuqi, te vlefshme, në ditën e hapjes së procedurës.
- b. Të kete minimumi 7 vjet përvojë pune si ekspert i licensuar ne vlerësimin e pasurive te paluajtshme.
- c. Eksperiencia ne projekte te ngjashme me shërbimet që këkohen, perben avantazh.
- d. Të zotërojë gjuhën angleze.

6. 1 (një) Ekspert ne fushen e arkeologjise

- a. Te jete i licensuar per veprimtari arkeologjike nga Ministria e Kultures, Rinise dhe Sportit. Licensa duhet të jetë në fuqi, te vlefshme, në ditën e hapjes së procedurës.
- e. Të kete minimumi 10 vjet përvojë pune si ne fushen e arkeologjise.
- f. Eksperiencia ne projekte te ngjashme me shërbimet që këkohen, perben avantazh.
- g. Të zotërojë gjuhën angleze.

7. 1 (një) Ekspert ne fushen e restaurimit

-
- a. Te jete i licensuar ne projektim per veprimtari nderhyrese ne pasurite kulturore materiale: P/A/1, P/A/2/ P/A3/ dhe P/A/4 nga Ministria e Kultures, Rinise dhe Sportit. Licensa duhet te jetë në fuqi, te vlefshme, në ditën e hapjes së procedurës.
 - b. Të kete minimumi 10 vjet përvojë pune si ne fushen e arkeologjise.
 - c. Eksperienca ne projekte te ngjashme me shërbimet që këkohen, perben avantazh.
 - d. Të zotërojë gjuhën angleze.

Shenim: Për efekt të vlerësimit me pike sipas pikes 4.4 ne Njoftimin e Kontrates, operatorët të ngarkojnë dokumentacionin: *Diplomë, Libre të pune, CV, si dhe deshmi kualifikimi/ specializimi, licensa/certificata profesionale/ leter referenca ose **cdo lloj dokumeti tjetër ekuivalent që vërteton përmushjen e kriterëve të kërkuara si me sipër.***

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10.. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë:

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.3.5 Stafi i angazhuar duhet të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë. Per stafin e angazhuar - Marreveshje/kontrate shërbimi apo deklarate nga vete eksperti ku te shprehet angazhimin me operatorin fitues kundrejt zbatimit te shërbimit per kete object prokurimi (perskrim per funksionin/rolin qe do te kryeje dhe detyrat perkatese).

2.3.6 Për plotësimin e kriterit të “**Përqasjes teknike dhe metodologjisë**” Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një deklaratë ku të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfituar rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve, të paraqesi problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Gjithashtu, duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesin kompatibilitetin e kësaj metodologjie me përqasjen e propozuar, duke mos përsëritur/kopjuar Termat e Referencës.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Një ekspert nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Dokumentet e lëshuara nga autoritete publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vërtetuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hagës për Vulën Apostile, të datës 05.10.1961.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

